



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Oda e Farmacistëve të Kosovës

Komora Farmaceuta Kosova

Chamber of Pharmacists of Kosovo

Hr.Br.No. 271 dt. 30/12/24

RREGULLORE MBI PUNËN E ORGANeve KOLEGJIALE TË ODËS SË FARMACISTËVE TË KOSOVËS

Prishtinë, 2024

KUVENDI I ODËS SË FARMACISTËVE TË KOSOVËS, në mbështetje të nenit 19, paragrafi 1, nënparografi 1.1 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë Nr. 04/L-150 dhe nenit 21, paragrafi 1, nënparografi 1.1 të Statutit të Odës së Farmacistëve të Kosovës nr 134 të datës 04/06/2024, në mbledhjen e mbajtur më datë 14/12/2024, nxjerrë këtë:

RREGULLORE MBI PUNËN DHE VENDIMARRJEN E ORGANEVE KOLEGJIALE TË ODËS SË FARMACISTËVE TË KOSOVËS



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Oda e Farmacistëve te Kosovës
Komora Farmaceuta Kosova
Chemistry of Pharmacists of Kosovo
Nr.Br.No. 271 D 30/12/24

I.

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Qëllimi

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen procedurat e vendimmarrjes të organeve të odës lidhur me ushtrimin e kompetencave që janë të parapara me Ligjin për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Statutin dhe aktet normative të OFK-së (tash e tutje Oda). Procedurat e vendimmarrjes përfshinë punën e organeve të odës, që përfshinë përgatitjen dhe thirrjen e mbledhjeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme, kryesimin e mbledhjeve, rendin dhe rregullin e mbledhjeve të thirrura, procedurat e votimit për qëllim të vendimmarrjes dhe zbatimi i vendimeve.

Fushëveprimi

Neni 2

1. Kjo rregullore zbatohet nga të gjitha organet e odës për zhvillimin e procedurave vendimmarrëse.
2. Kjo rregullore përfshinë dispozita të veçanta që zbatohen ekskluzivisht nga kuvendi i Odës për shkak të kompetencave të veçanta të kuvendit si organ më i lartë i Odës. Dispozitat e veçanta përkizazi me punën e kuvendit të Odës nuk zbatohen për organet tjera të Odës

Përkufizimet

Neni 3

1. Termet dhc akronimet të përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:

- 1.1 **Organ** – nënkupton organet që përkufizohen si autoritete që përbëhen nga dy o më shumë persona të zgjedhur, që ushtrojnë autorizimet e bazuara në ligj, statutin e odës dhe aktet të tjera normative;
- 1.2 **Konflikti i interesit** – nënkupton rrëthanën në të cilën anëtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të funksionit të tij zyrtar.

- 1.3 **Kryesuesi i mbledhjes** – nënkupton kryetarin, zëvendëskryetarin apo personin e autorizuar sipas Statutit dhe kësaj rregullore i cili drejton mbledhjen e organit;
2. Termet dhe fjalitë që nuk janë të përfshira në përkufizimet sipas kuptimeve të dhëna në paragrafin 1 të këtij neni, do të interpretohen sipas kuptimeve të përgjithshme gjuhësore dhe njohurive të përgjithshme shkencore dhe teknike.

II. TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E ANËTARËVE TË ORGANEVE KOLEGJIALE

Neni 4

1. Anëtarët e organeve të OFK-së kanë këto të drejta dhe përgjegjësi:
 - 1.1. Të jenë prezent në mbledhjet dhe të marrin pjesë në punën dhe marrjen e vendimit të tij;
 - 1.2. Të iniciojnë shqyrtimin e çështjeve nga fushëveprimtaria dhe të propozojnë që ato të vihen në rend të ditës;
 - 1.3. Në rast pengese për të marrë pjesë në mbledhje duhet paraprakisht ta njoftojnë kryesuesin dhe Shërbimin Profesional të Odës;
 - 1.4. Të propozojë ndryshimin e rendit të ditës në rast se mund të mblidhet material për atë mbledhje;
 - 1.5. T'i përbahet rendit të ditës;
 - 1.6. Në rast se anëtar i organit mungon në tri mbledhje pa justifikim, kryesuesi mund t'i propozojë Këshillit Drejtues iniciimin e shkarkimit të njëjtë dhe zgjedhjen e anëtarit të ri. Shkarkimi dhe zgjedhja e anëtarit të ri bëhet nga Kuvendi i OFK-së;
 - 1.7. T'i parashtrojë pyetje organit anëtar i së cilit është. Pyetja mund të parashtronhet gojarisht ose me shkrim. Nëse përgjigjja anëtarit nuk i jepet në mbledhjen e njëjtë të organit ose në rastet e parashtruara në mes dy mbledhjeve të organit, kryetari i organit ka për obligim që parashtruesit të pyetjes t'i japë përgjigje me shkrim më së largu 30 ditë nga dita e parashtrimit të pyetjes;
 - 1.8. Të marrë pjesë në mbledhjet e organeve të odës ku nuk është anëtar pa të drejtë vote;
 - 1.9. Anëtarëve të organeve për angazhimin e tyre dhe pjesëmarrjen në mbledhje u takon një kompensim lartësia e së cilës caktohet me vendim të Kuvendit të Odës së Farmacistëve.
2. Shërbimi Profesional i Odës do të ofrojë asistencë profesionale për punën e organeve të Odës dhe anëtarëve të tyre për mbledhje.

Neni 5
Kompetencat e Kryesuesit të Organit

1. Kryesuesi i organit gjëgjës të odës ka këto kompetenca dhe përgjegjësi :
 - 1.1.Thërret mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme në përputhje me legjislacionin në fuqi :
 - 1.2.Kujdeset për zbatimin e plotë të procedurave të parapara me këtë rregullore;
 - 1.3.Përpilon dhe propozon rendin e ditës për trajtimin e çështjeve;
 - 1.4.Kujdeset për rregullsinë e mbajtjes së mbledhjes dhe rendit në të;
 - 1.5.Kryeson mbledhjet e thirrura sipas kësaj rregulloreje;
 - 1.6.Në mungesë të Kryetarit/ës, mbledhja mund të udhëhiqet nga zëvendëskryetari/ja apo nga anëtarë më i vjetër i organit.
 - 1.7.Interpreton dispozitat e kësaj rregulloreje gjatë takimit. Kundër interpretimit mund të paraqitet ankesë në këshillin drejtues të odës. ; dhe
 - 1.8.Kujdeset për çështjet të tjera që janë të nevojshme për funksionimin e organit gjëgjës.
 - 1.9.Në rast të mungesës së kryetarit/ës, të gjitha kompetencat nga paragrafi 1 i këtij nenii do t'i ushtron zv. Kryetari/ja i/e organit gjëgjës, apo anëtarë më i vjetër i organit.

Humbja e mandatit të anëtarit të Organit
Neni 6

1. Anëtarët e organeve humbin mandatin e tyre para përfundimit të rregullt të mandatit në këto raste:
 - 1.1 Me dorëheqjen me shkrim të anëtarit;
 - 1.2 Me shkarkimin nga Kuvendi i OFK-së nëse anëtarët e atij organi zgjidhen nga Kuvendi.;
 - 1.3 Me shkarkimin nga njësia zgjedhore e cila e ka zgjedhur nga organet në të cilat kërkon të jetë anëtar i Kuvendit;
 - 1.4 Mungon më shumë se tre herë në mbledhjen e organit pa njoftimin dhe arsyetimin te kryesuesit apo shërbimit profesional
 - 1.5 Në rast të humbjes së statusit të anëtarit të OFK-së;
 - 1.6 Në rast të dënimit me vendim të plotfuqishëm të gjykatës me një apo më shumë vite burgim efektiv;
 - 1.7 Nëse organet etike me vendim të formës së prerë tërheqin licencën e anëtarit për periudhë jo më pak se 3 vite.
 - 1.8 Me vdekjen e anëtarit të OFK-së.

2. Anëtari i larguar nga organi përkatës zëvendësohet në pajtim me aktin të veçantë normativ përkitazi me zgjedhjet e brendshme të Odës

III. MBLEDHJET E ORGANEVE KOLEGJIALE

Mbledhjet/Kourumi

Neni 7

1. Organet gjegjëse të odës mbajnë mbledhje sipas nevojave dhe kërkesave të parashtruara lidhur me çështjet që janë në kompetencë të tyre. Secili organ gjegjës është i obliguar që të paktën të mbajë mbledhje në çdo 6 (gjashtë) muaj, nëse me statusin e OFK-së nuk është përcaktuar ndryshe.
2. Organet gjegjëse mbajnë mbledhjet e irregullta dhe të jashtëzakonshme që thirren sipas mënyrës së paraparë me Statut dhe këtë irregullore
3. Mbledhja e irregullt e organit gjegjës thirret nga kryetari i organit gjegjës, përkatësisht nga zv.kryetari në rast të mungesës së kryetarit apo në mungesë të zv. Kryetarit nga anëtari më i vjetër i organit. Mbajtja e mbledhjeve kordinohet me shërbimin profesional të OFK-së për organizimin e procesit administrativ, të cilët e ftojnë mbledhjen në emer të kryesuesit të organit.
4. Ftesa për mbledhje me rendin e propozuar të ditës u dërgohet anëtarëve të organit gjegjës së paku 48 orë më herët. Ndërkakq ftesa për mbledhje të jashtëzakonshme me rendin e propozuar të ditës u dërgohet anëtarëve të organit gjegjës, së paku 24 orë më herët. Ftesa dërgohet me shkrim, e-mail apo në çfarëdo forme të informimit me të cilin ftesa arrin te anëtarët e organeve
 - a. Përjashtimisht nga ky paragrafi, afatet për thirrjen e Kuvendit përcaktohen sipas Statutit të OFK-së.
5. Organet kolegjiale mbajnë takime jashtë paragrafit 1, nëse ka kërkesa nga palët të cilat janë në fushëveprim të organit.
6. Njoftimin mbi kërkesën e palëve e bën Shërbimi Profesional i OFK-së jo më vonë se 48 orë nga dita e pranimit të kërkesës nga palët.
7. Mbledhjet e mbajtura jashtë paragrafit 1 dhe 5, mbahen me miratim të Këshillit Drejtues si përgjegjës për koordinimin e punës në mes të organeve të OFK-së sipas ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë dhe statutit të OFK-së.

8. Pikat e rendit të ditës përcaktohen nga kryetari i organit kolegjial.
9. Kuorumi i nevojshëm për mbajtjen e mbledhjeve të organeve kolegjiale është pjesëmarrje e së paku 50% +1 anëtarëve të organit.
10. Organi kolegjial ka të drejtë në çfarëdo kohe t'i propozojë Këshillit Drejtues të ftojë në mbledhje ekspertë ose persona të tjera me qëllim të sqarimit të çështjeve profesionale të domosdoshme që kërkojnë vendimmarrje nga organi.

Konflikti i interesit i anëtarëve të organeve gjegjëse
Neni 8

1. Nëse një anëtar ka konflikt interesi me një çështje që paraqitet për shqyrtim pranë organit gjegjës, i njëjti duhet ta lëshoja mbledhjen gjatë asaj kohe kur ajo çështje diskutohet.
2. Në rastet e paraqitjes së rrëthanave që përbëjnë konflikt të interesit, anëtar i organit gjegjës i cili gjindet në rrëthanë të tillë është i obliguar që të deklarojë rrëthanën e tillë në momentin që është në dijeni për rrëthanën e tillë.
3. Secili nga anëtarët kur është në dijeni se ndonjëri nga anëtarët e organit gjegjës është në konflikt të interesit, është i obliguar që të deklarojë konfliktin e interesit të cilidh anëtar të organit gjegjës.
4. Për çështjet më të hollësishme përkitazi me konfliktin e interesit do të zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.
5. Për zbatimin e kësaj dispozite do të kujdeset kryetari i organit gjegjës.

Mbledhjet e jashtëzakonshme
Neni 9

1. Mbledhjet e jashtëzakonshme mund të thirren nga kryetari i organit gjegjës, kërkesën e 1/2 anëtarëve të organit gjegjës. Këshillit Drejtues apo Kryetarit të Odës
2. Këshilli Drejtues shqyrton kërkesat për mbajtjen e takimeve jashtë paragrafeve 1 dhe 5 të nenit 6, jo më larg se 24 orë nga parashtrimi i kërkesës nga organi apo subjektit
 - a. Përjashtmisht ky paragrafi nuk zbatohet për kërkesat e Këshillit Drejtues dhe Kryetarit të Odës.

Pjesëmarrja në mbledhje

Neni 10

1. Si rregull, mbledhja e organit kolegjial mbahet me prezencën fizike të anëtarëve. Me pëlqimin e shumicës së të gjithë anëtarëve të pranishëm por jo më pak se 40% e anëtarëve të atij organi, mbledhja mund të mbahet dhe me pjesëmarrjen e anëtarëve nëpërmjet videokonferencës apo me mjete të tjera të përshtatshme të komunikimit simultan në distancë, nëse nga kjo pjesëmarrje varet kourumi për mbajtjen e takimit.
2. Para se të fillojë mbledhja e organit, anëtarët do të nënshkruhen në listën e pjesëmarrjes e cila i bashkëngjitet procesverbalit, në rast të pjesëmarrjes së anëtarit me videokonferencë nënshkrimin e pjesëmarrjes e bën në mbledhjen e radhës.
3. Anëtari i organit mund të mungojë nga mbledhja për shkaqe të arsyeshme. Për mosardhje në mbledhje anëtari duhet ta njoftojë me kohë kryesuesin.
4. Anëtarët e organeve obligohen që të paralajmërojnë konfliktin e interesit, sipas dispozitave ligjore në fuqi, dhe të tillët duhet të tërhiqen nga vlerësimi dhe vendimmarra në rastet e tillë. Konflikti i interesit sipas kësaj Rregulloreje konsiderohet definimi dhe përcaktimi i paraparë me Ligjin Nr. 06/L – 011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Ecuria e mbledhjes

Neni 11

1. Kryesuesi e hap, e kryeson, e ndërprenë dhe e përfundon mbledhjen.
2. Për përgatitjen e materialeve për mbledhjen e organeve kujdeset kryesuesi i mbledhjes dhe Shërbimi Profesional i OFK-së.
3. Në fillimin e mbledhjes, kryesuesi e verifikon kuorumin përmes listës së pjesëmarrjes.
4. Para se të fillojë mbledhja e organit gjegjës, anëtarët do të nënshkruhen në listën e pjesëmarrjes e cila është pjesë integrale e procesverbalit. Anëtari i organit gjegjës mund të mungojë nga mbledhja për shkaqe të arsyeshme. Për mosardhje në mbledhje, anëtari i organit gjegjës duhet ta njoftojë me kohë kryetarin e organit gjegjës. Lista e pjesëmarrjes qëndron e pranishme për evidentim jo më shumë se 15 minuta nga koha e cila është caktuar për mbajtjen e takimit. Për listën e pjesëmarrjes kujdeset shërbimi profesional i OFK-së.

5. Kryesuesi propozon rendin e ditës. Hap diskutimin rrëth rendit të ditës dhe pas përfundimit të diskutimeve propozimet i hedh në votim dhe konstaton miratimin apo mosmiratimin e rendit të ditës.
6. Anëtarët e organeve kanë të drejtë të propozojnë plotësimin dhe ndryshimin e rendit të ditës, nëse është e mundur që për këtë ndryshim të sigurohen materialet e nevojshme për diskutim.
 - a) Plotësim ndryshimi i rendit të ditës me materialin përcjellës mund të bëhet jo më vonë se 24 orë para mbajtjes së mbledhjes përmes emailit. Jashtë këtij afati mund të vendoset vëtm me votat e 2/3 të anëtarëve të atij organi.
7. Anëtarët e organit, pas miratimit të rendit të ditës, duhet të zhvillojnë punimet sipas rendit të miratuar.
8. Raportin dhe arsyetimin rrëth secilës pikë të rendit të ditës e paraqet kryesuesi pas të cilit ai e hap diskutimin.
9. Kryesuesi i jep fjalën në kohëzgjatje prej 5 minutave diskutuesit për të diskutuar mbi temën në trajtim, për aq kohë sa diskutuesi nuk ka dalë jashtë rendit të ditës, nuk përdorë fjalor joinstitucional, fyes apo denigrues si dhe për aq kohë sa nuk përsërit propozimet e thëna njëherë. Anëtarë i Kuvendit nuk mund të marrë fjalën pa lejen e kryesuesit të mbledhjes.
10. Gjatë diskutimit të tyre, anëtarët janë të obliguar që tu përbahen rendit të ditës. Kryesuesi/ja i/e mbledhjes ka të drejtë që t'ia tërheqë vërejtjen anëtarit dhe të kërkojë nga ai/ajo që t'i përbahet diskutimit lidhur me pikën e rendit të ditës. Nëse anëtarë nuk i bindet vërejtjes së kryesuesit/ës, ndaj tij/saj mund të merren masat që janë të parapara me dispozitat e kësaj rregulloreje.
11. Kryesuesi i organit, në rast të prishjes së rendit dhe qetësisë, anëtarit të organit mund t'i shqiptojë këto masa:
 - a. Vërejtjen,
 - b. Ndërprerjen e diskutimit,
 - c. Të kërkojë nga anëtarë që të tërheq fjalën;
 - d. Të kërkojë nga anëtarë që të kérkon falje për fjalorin e papërshtatshëm dhe ofendues të përdorur nga ai;
 - e. Largimin nga mbledhja,
 - f. Humbja e mëditjes nga anëtarët.

12. Kryesuesi e jep fjalën sipas radhës së paraqitjes për diskutim, si dhe përkujdeset për racionalisimin e kohës gjatë shqyrtimeve dhe diskutimeve.
 13. Kryesuesi në rastet kur anëtari kërkon fjalën për herë të dytë brenda diskutimit për pikën e njëjtë të ditës, redukton diskutimin e tij në kohëzgjatje prej 2 minutave për shkak të mbarëvajtjes kohore të mbledhjes.
 14. Anëtari i organit emri i të cilit është përmendur gjatë diskutimit ka të drejtë në replikë në kohëzgjatje prej 3 minutave.
 15. Anëtari i organit ndaj diskutimit të të cilit është replikuar ka të drejtën e kundëreplikës në kohëzgjatje prej 1 minute.
 16. Organi kolegjal në bazë të propozimit të kryesuesit apo të ndonjë anëtari, mund të vendosë që shqyrtimi për disa çështje specifike të ndërpritet dhe të përgatitet më hollësisht për mbledhjen e ardhshme.
 17. Kryesuesi ka të drejtë ta ndërpresë mbledhjen nëse ai konstaton se nuk ka kushte normale për mbajtjen e mbledhjes.
-
18. Pas përfundimit të diskutimeve të paraqitura nga anëtarët e kuvendit, kryesuesi/ja i/e mbledhjes konstaton se diskutimi është përbyllur për atë pikë të rendit të ditës.
 19. Varësish nga natyra dhe përbajtja e pikës së rendit të ditës, kryesuesi/ja i/e mbledhjes do ta hedhe në votim propozimin e konkluduar, aktin juridik të diskutuar në pikë të rendit të ditës, apo propozimet e parashtruara gjatë diskutimit për pikën e rendit të ditës.
-
20. Rendi i ditës për mbledhjen e jashtëzakonshme nuk i nënshtronhet miratimit, dhe i njejti nuk mund të ndryshohet gjatë mbledhjes.
 21. Këshilli Drejtues është përgjegjës dhe kujdeset për respektimin dhe interpretimin e Rregullores së Punës.

IV. VENDIMMARRJA DHE TRANSPARENCA

Kourumi i vendimmarrjes Neni 12

1. Organet mund të vendosin për pikat e rendit të ditës vetëm nëse ka kourum për mbajtjen e mbledhjes.

2. Mbledhjet e organit gjegjës kanë kuorum kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të organit gjegjës
3. Në mungesë të kuorumi, kryesuesi i mbledhjes e ndërpret mbledhjen deri në caktimin e takimit të radhës duke konstatuar rrethanën e tillë në procesverbalin e mbledhjes së thirrur.
4. Para se të votohet për një çështje, kryesuesi e formulon propozimin e vendimit ose të kërkesës lidhur me atë pikë të rendit të ditës.
5. Vendimmarja në organe bëhet me vota të hapura. Vendimmarja me vota të fshehta mund të bëhet përjashtimisht në rastet kur për këtë formë votojnë më shumë se gjysma e anëtarëve prezentë në mbledhje.
 - a. Statuti i OFK-së miratohet dhe ndryshohet me vendim të 2/3 të anëtarëve të përgjithshëm të Kuvendit (40 Vota).
6. Votimi bëhet: “për”, “kundër” dhe “abstenim”.
7. Vendimet e organit kolegjal mund të miratohen edhe me një procedurë qarkulluese, Procedura qarkulluese, sipas këtij paragrafit, është procedura e votimit, në të cilën anëtarët votojnë individualisht, me shkrim, pa qenë e nevojshme mbledhja e organit kolegjal.
8. Procedura qarkulluese nga paragrafi paraprak konsiderohet e sukseshme nëse në votim kanë marrë pjesë 2/3 e anëtarëve të atij organi.
9. Vota e anëtarëve të organeve është e barabartë dhe vendimi konsiderohet i aprovuar nëse për të kanë votuar më shumë se gjysma e anëtarëve prezentë në mbledhjen e organit.
10. Në rast barazie të votave, vota e kryesuesit është vendimtare, përvçese kur ai ka një pengesë ligjore për të votuar sipas ligjit.
11. Vota e anëtarëve të organeve nuk mund të delegohet.

Transparenca
Neni 13

1. Mbledhjet e organeve janë të hapura për opinionin.
2. Organet mund të vendosin për përjashtimin e opinionit nga i tërë takimi apo nga një pjesë e tij, në rast kur takimi i hapur kërcënët të zbulojë informacione të cilat janë të klasifikuara si të besueshme sipas ligjit mbi qasjen në dokumente zyrtare si dhe informacione të ndjeshme personale dhe komerciale.

3. Kërkesa për pjesëmarrje në mbledhjet e organeve duhet të bëhet me shkrim 36 orë para mbajtjes së mbledhjes, me qëllim të organizimit të hapësirës ku do të mbahet mbledhja. Kërkesa për pjesëmarrje miratohet nga Kryetari i Odës.
4. Njoftimi për mbajtjen e takimit të Kuvendit të OFK-së do të publikohet në ueb faqen e OFK-së.
5. Pjesëmarrësit në mbledhje nga ky nen kanë cilësinë e vëzhguesit dhe nuk kanë të drejtën e fjalës.

Raportimi dhe komunikimi i organeve **Neni 14**

1. Organet paraqesin raportet periodike të punës për cdo tremujorë të vitit në Këshillin Mbiqyrës.
2. Raportet e vlerësuara nga Këshilli Mbikqyrës paraqiten për miratim në Këshillin Drejtues. Raportet e miratuara të punës së organeve nga Këshilli Drejtues paraqiten nga Kryetari i OFK-së në Raportin vjetor të punës së OFK-së në Kuvend.
3. Organet paraqesin edhe planifikimin e punës për vitin e ardhshëm në Këshillin Drejtues.
4. Komunikimi dhe bashkpunimi mes organeve të OFK-së mund të bëhet në mënyrë të drejtpërdrejt nga organet përmes njoftimit të shërbimit profesional të OFK-së dhe Kryetarit.
5. Komunikimi mes organeve të OFK-së, dërgimi i shkresave me organet apo subjektet fizike e juridike jashtë organeve të OFK-së bëhet me emailin zyrtar të odës apo përmes protokollit të saj, përmes Kryetarit dhe njofitimit të shërbimit profesional .
6. Kërkesat të cilat paraqesin vërtetim të fakteve nga të dhënat e regjistrave zyrtar të OFK-së (si vërtetimet e anëtarësisë, certifikata good of standing , vërtetimi mbi validitetin e licencës, përshkrimi i të drejtave të tjera për të cilat nuk kërcohët paraqiten dokumente të reja për shqyrtim të fakteve, apo kërkesa tjera të këtij karakteri) nënshkruhen nga Sekretari i përgjithshëm të OFK-së dhe Kryetari i OFK-së.
 - a. Përjashtimisht këtij paragrafi, vërtetimi mbi të kaluaren etike mund të nënshkruhet nga shërbimi profesional, nëse Kryesuesi i organit gjegjës nuk e nënshkruan të njejin brenda 5 ditësh nga dita e njoftimit për kërkesen. Këto kërkesa validohen me nënshkrimin e Kryetaritë të OFK-së.

7. Në rast refuzimi nga Kryetari sipas paragrafit 5, organi pranon arsyen e refuzimit ndaj të cilës ka të drejten e ankesës në Këshill Drejtues brenda 7 ditëve nga njoftimi i Kryetarit.
8. Vendimi i Këshillit Drejtues është përfundimtar dhe i nejti mund të atakohet në procedurë të konfliktit administrativ.

Procesverbalet

Neni 15

1. Në secilën mbledhje mbahet një procesverbal, në të cilin përfshihen:
 - 1.1. Data dhe vendi i mbledhjes;
 - 1.2. Anëtarët që morën pjesë;
 - 1.3. Çështjet që u diskutuan dhe pretendimet e anëtarëve;
 - 1.4. Vendimet që u morën; si dhe
 - 1.5. Forma dhe rezultati i votimeve.
2. Anëtarët e organit kolegjal mund të kërkojnë që vota kundër e tyre dhe arsyetimi përkatës të përfshihet në procesverbal.
3. Procesverbali paraqitet për miratim në fund të mbledhjes përkatëse ose në fillim të mbledhjeve pasuese. Para miratimit kryesuesi i jep mundësinë anëtarëve t'i shprehin vërejtjet e tyre lidhur me procesverbalin. Nëse ndaj vërejtjeve të shprehura paraqiten kundërshtime nga anëtari tjetër, kundërshtimi i tillë do të konstatohet në procesverbal.
4. Në rast të vërejtjeve kryesuesi e hedh në votim fillimisht verejtjen nga anëtari e bastaj e pastaj procesverbalin së bashku me vendimin për vërejtjen. Pas miratimit, procesverbali nënshkruhet së bashku nga kryetari dhe anëtari që ka mbajtur procesverbalin.
5. Procesverbali mund te regjistrohet edhe me mjete audio-vizuale. Dëgjimi audio vizuel mund të dëgjohet vetëm në mbledhje të organit dhe i nejti nuk i dorëzohet personalisht anëtarëve. Dëgjimi audio vizuel ruhet deri në miratimin e procesverbalit nga ai takim për të cilin është mbajtur.

V. MBLEDHJA KONSTITUIVE E ORGANeve

Mbledhja konstitutive e Kuvendit

Neni 16

1. Mbledhja konstitutive thirret nga kryetari/ja i/e Odës nga mandati i kaluar në afat prej së largu 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e certifikimit të rezultateve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ).
2. Ftesa dhe rendi i ditës u dërgohet anëtarëve të zgjedhur të kuvendit në afat prej jo më larg se 7 (shtatë) ditëve para ditës së mbajtjes së mbledhjes konstitutive.

3. Rendi ditës i mbledhjes konstitutive të Kuvendit nuk i nënshtrohet votimit në kuvend dhe përmban :
 - 3.1. Përcaktimin e procesmbajtësve dhe verifikuesve;
 - 3.2. Betimin e anëtarëve të Kuvendit ;
 - 3.3. Zgjedhjen e Kryetarit/ës të Odës;
 - 3.4. Zgjedhjen e zv. Kryetarëve, me propozim të Kryetarit/ës të Zgjedhur;
 - 3.5. Çështje tjera të përcaktuara nga KQZ, në implementimin e pikave paraprake nga ky paragraf.
4. Kryesimi i mbledhjes konstitutive deri në përfundimin e procesit të zgjedhjes së kryetarit/ës dhe zëvendëskryetarëve të Odës, bëhet nga kryetari/ja i/e Odës nga mandati i kaluar, i ndihmuar nga dy anëtarë të kuvendit, anëtari më i vjetër në moshë dhe anëtari më i ri.
5. Mbledhja konstitutive konsiderohet e përfunduar me zgjedhjen e kryetarit/ës dhe zëvendëskryetarëve të Odës nëse ata propozohen nga Kryetari/ja.
6. Në rast të rikandidimit të Kryetarit/ës nga mandati i kaluar apo refuzimi të drejtimit të mbledhjes, mbledhja e Kuvendit do të udhëhiqet nga anëtari prezent më i vjetër i ndihmuar nga anëtari më i ri dhe kryetari i KQZ-së.

Rrjedha e mbledhjes konstitutive

Neni 17

1. Kryesuesi i mbledhjes konstitutive hapë mbledhjen konstitutive duke e deklaruar në mënyrë solemne fillimin e punimeve të kuvendit.
2. Pas hapjes së mbledhjes, kryesuesi verifikon numrin e anëtarëve të pranishëm në mbledhjen konstitutive.
3. Kryesuesi i mbledhjes konstitutive konstaton përbushjen e kuorumi sipas paragrafit 2 të këtij nenii, pas së cilës , kryesuesi thërret përfaqësuesin e KQZ-së që të bëjë leximin e emrave të anëtarëve që kanë fituar mandatin sipas rezultatit të certifikuar.

Betimi i anëtarëve të Kuvendit

Neni 18

1. Pas verifikimit të mandateve, anëtarët e Kuvendit betohen solemnisht. Teksti i deklaratës është:

“Unë, anëtari i Kuvendit të Odës të Farmacistëve të Kosovës, betohem se me ndër e me përkushtim do ta kryej detyrën time dhe do të përfaqësoj me dinjitet interesat profesionale të anëtarëve të odës, promovoju dhe mbroj veprimtarinë profesionale shëndetësore dhe do të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së kujdesit shëndetësor”. Betohem!

2. Pas betimit, anëtarët e kuvendit e nënshkruajnë deklaratën e betimit, të cilën menjëherë duhet t'ia dorëzojnë shërbimit profesional të Odës.
3. Me dhënie të betimit, konsiderohet se anëtarët e kuvendit fitojnë autorizimin për të ushtruar funksionin e anëtarit të kuvendit sipas kompetencave të parapara me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme normative të Odës.
4. Deri në betimin e anëtarit, nënshkrimet apo veprimet e tij do të janë të vlefshme vetëm në mbështetjen për kandidim për kryetar të Odës.
5. Anëtar i Kuvendit që mungon në seancën konstitutive të legjislaturës kur bëhet betimi dhe anëtar i Kuvendit që fiton mandatin gjatë legjislaturës, betimin e bëjnë në seancën e parë të rregullt të radhës.
6. Anëtarët e Kuvendit të cilët nuk bëjnë betimin brenda dy takimeve të rregullta të njëpasnjëshme, konsiderohet se kanë humbur mandatin e anëtarit të Kuvendit.

Procedura e parashtrimit të propozim amandamentit për draftimin e akteve normative

Neni 19

1. Në rastet e draftimit të akteve të ndryshme juridike që shqyrtohen nga kuvendi i Odës, anëtarëve të kuvendit do tu ofrohet materiali të paktën 7 (shtatë) ditë para mbajtjes së mbledhjes.
2. Anëtarët e kuvendit janë të obliguar që propozim amandamentin e tyre ta paraqesin në formë të shkruar jo më vonë se 2 (dy) ditë para mbajtjes së mbledhjes së thirrur në të cilën do të shqyrtohet akti i cili procedohet për miratim.
3. Për shqyrtim nga kuvendi do të merren parasysh vetëm propozim-amandamenti i parashtruar në formë të shkruar në përputhje me paragrafin 2 të këtij nenit.
4. Nëse ka më shumë amandamente për të njejtën çështje të rendit të ditës, kryesuesi i kuvendit, amandamentet i vënë në votim sipas rendit të paraqitjes së tyre.
5. Ushtruesi i amandamentit mund të tërhjek amandamentin gjatë shqyrtimit deri sa ai mos të shkojë në votim.
6. Nëse amandamenti miratohet ai bëhet pjesë përbërëse e aktit.
7. Sëpari hudhet në votim propozimi i amandamentit që vjen nga anëtarët e Kuvendit. Me shumicën e thjeshtë të anëtarëve prezentë propozimi i aktit normativ konsiderohet i miratuar.
Më pastaj votohet akti i propozuar përfshirë edhe propozimin e anëtarit nëse i njejti është votuar nga Kuvendi.

8. Propozimet në formë të shkruar anëtarët e kuvendit i dërgojnë përmes postës elektronike në adresën zyrtare të Odës.

Mbledhja konstitutive e organeve të tjera
Neni 20

1. Mbledhjen konstitutive e thërret kryetari i organit nga mandati i kaluar jo më larg se 30 ditë nga zgjedhja e organit.
 - a) Në rast se takimi nuk thirret nga kryetar i organit nga mandati i kaluar, takimin e thërret kryetari i ri i komisionit.

VI. E DREJTA E ANKESËS DHE MASAT

E drejta e ankesës
Neni 21

1. Anëtari i organit ndaj të cilit është shqiptuar ndonjë masë nga kryesuesit e organeve të OFK-së kanë të drejtën e ankesës në Këshillin Drejtues brenda 7 ditëve nga dita e shqiptimit të masës.
 - a. Përjashtimisht këtij paragrafi masat e shqiptuara nga Kryetari i Kuvendit nuk mund të atakohen
2. Vendimet e Këshillit Drejtues janë përfundimtare dhe të njejtat nuk mund të atakohen brenda Odës.

Masat e shqiptuara në rast të shkeljes së rregullorës
Neni 22

1. Këshilli Drejtues monitoron sipas detyrës zyrtare apo me kërkesë zbatimin e dispozitave të kësaj rregullore. Ndaj anëtarëve të cilët veprojnë në kundërshtim me të, Këshilli Drejtues mund të ndërrmarrë këto masa në vartësi nga shkelja dhe konstatimi i Këshillit Drejtues :
 - a. Vërejtejen ndaj anëtarit
 - b. Kërkim faljen
 - c. Humbjen e mëditjes për periudhë 3- 6 mujore
 - d. Pezullimin e përkohëshëm nga funksioni deri në mbledhjen e parë të Kuvendit , i cili vendos për shkarkimin apo vazhdimin e funksionit.
2. Vendimet e Këshillit Drejtues janë përfundimtare dhe të njejtat nuk mund të atakohen brenda Odës.

VII. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Përshtatshmëria e zbatimit të dispozitave të tjera
Neni 21

Kuvendi i Odës do të zbatojë të gjitha dispozitat të tjera të parapara me këtë rregullore në mënyrë të përshtatshme me dispozitat e veçanta që janë paraparë për punën e tij.

Hyrja në fuqi
Neni 17

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj irregullore shfuqizohen të gjitha dispozitat e irregulloreve të tjera të cilat janë në kundërshtim me këtë rregullore.
2. Kjo irregullore hyn nw fuqi nga 1 Janar 2025

Prishtinë 14/12/2024

Kryetari i OFK-së
Mr. Ph. Kadri Bytyqi

